

Mundësi për aplikim në thirrjen “A European Collaborative Cloud for Cultural Heritage – Innovative tools for advanced data enrichment HORIZON-CL2-2024-HERITAGE-ECCCH-01-03” nën Programin Horizon Europe

Synimi i Thirrjes:

Kjo thirrje synon zhvillimin e mjeteve dhe metodave inovative për të pasuruar të dhënat dhe metadatat në “Retë Bashkëpunuese Europiane për Trashëgiminë Kulturore” (European Collaborative Cloud for Cultural Heritage) (ECCCH).

Objektivat kryesore përfshijnë:

- Pasurimi i Metadatave.
Ofrimi i mjeteve që mundësojnë krijimin dhe përmirësimin e metadatave të cilësisë së lartë për objektet e trashëgimisë kulturore.
- Integrimi i Vlerave Shkencore dhe Profesionale.
Zhvillimi i mjeteve që regjistrojnë dhe ndajnë të dhëna, procese dhe metoda të krijimit digjital, duke përfshirë të drejtat e pronës intelektuale.

Modele Bashkëpunimi dhe Biznesi

- Eksperimentimi me modele të reja bashkëpunimi dhe biznesi bazuar në zinxhirë vlerash të përbashkëta për burimet digjitale.

Rezultatet e Pritshme:

- Përdorim i gjerë i ECCCH nga profesionistët dhe studiuesit për të menaxhuar dhe pasuruar të dhënat digjitale.
- Ndërgjegjësim mbi modelet e reja të bashkëpunimit dhe të biznesit për burimet digjitale.
- Sigurimi i moduleve të trajnimit dhe informacionit të qartë për përdoruesit.

Karakteristikat Kryesore:

- Zhvillimi i mjeteve të reja për kategorizimin dhe anotimin e objekteve digjitale, duke përfshirë tekstet, imazhet, modelet 3D dhe videot.
- Krijimi i zinxhirëve të të dhënave që pasqyrojnë proceset e krijimit dhe pasurimit të burimeve digjitale, duke përdorur teknologji si blockchain.
- Mbështetje për ndërlidhjen e të dhënave dhe bashkëpunimin shumë-sektorial për të lehtësuar përdorimin dhe ripërdorimin e burimeve të trashëgimisë kulturore.

Kriteret e Konsorciumit:

Të përfshihen të paktën **3 entitete** ligjore të pavarura nga vende të ndryshme të BE-së ose vende të asociuara, të paktën **1 nga Vendet Anëtare** dhe **2 nga Vendet Anëtare dhe Vendet e asociuara**.

Buxheti:

Buxheti total për këtë thirrje është **12 milionë euro** dhe thirrja do të financojë **2 projekte** me grante që variojnë nga **5 deri në 6 milionë euro për projekt**.

Mënyra e Aplikimit:

Aplikimi kryhet përmes portalit të BE-së për Financime dhe Tendera dhe afati i fundit për dorëzimin e projekt-propozimeve është më datë **22 Janar 2025, ora 17:00 (ora e Brukselit)**

Link i Thirrjes:

<https://ec.europa.eu/info/funding-tenders/opportunities/portal/screen/opportunities/topic-details/HORIZON-CL2-2024-HERITAGE-ECCCH-01-03?isExactMatch=true&status=31094501,31094502&frameworkProgramme=43108390&call>

Identifier=HORIZON-CL2-2024-HERITAGE-ECCCH-
01&order=DESC&pageNumber=1&pageSize=50&sortBy=startDate